Shkollimi për "Asistent turistik", niveli I dhe II, u referohet veprimtarive të punës ndihmëse në agjenci turistike si dhe në sektorin e pritjes dhe akomodimit në hotele, institucione, organizata të ndryshme. Niveli II, i referohet veprimtarive në sektorin e pritjes dhe akomodimit, administratës në hotel si dhe në agjenci turistike të udhëtimit. Nisur nga kjo, Asistenti turistik i nivelit të I dhe II mund të punësohet në hotele, agjenci turistike të të gjitha kategorive, ose mund të vetëpunësohet si Asistent turistik. Me kualifikime të mëtejshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Kompetencat profesionale: Me përfundimin e suksesshëm të shkollimit dyvjeçar në profilin "**Asistent turistik**", ***niveli I***, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Respekton kodin e etikës turistike të sjelljes me klientët dhe personelin,
- Kryen punë ndihmëse në të gjitha repartet në hotel,
- Përgatit inventarin dhe pajimet për shërbim në restorant,

- Kryen punë ndihmëse në depo dhe njihet me artikujt, inventarin dhe dokumentacionin përcjellës,
- Kryen punë ndihmëse në banak dhe shërbimin e pijeve të ndryshme,
- Kryen punë ndihmëse në kuzhinë si dhe me pajimet dhe inventarin,
- Udhëheq vizitën në monumentet e trashëgimisë kulturore,
- Udhëheq vizitën në atraksione turistike,
- Udhëheq vizitën në panaire turistike,
- Kryen punë ndihmëse në sektorin e akomodimit,
- Kryen punë ndihmëse në kate,
- Kryen punë ndihmëse si dhe komunikon me klientë dhe kryen ndonjë shërbim të imët,
- Pret dhe merr porosinë e klientit,
- Përkujdeset për realizimin e kërkesave të klientit,
- Kryen punë ndihmëse në administratën e hotelit,
- Dallon ofertat turistike, marrëveshjet ndërmjet agjencive turistike dhe hotelit,
- Zbaton rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Me përfundimin e suksesshëm të shkollimit të mëtejshëm njëvjeçar në profilin mësimor "**Asistent turistik**", ***niveli II***, nxënësi do të rrisë në një shkallë më të lartë nivelin e kompetencave profesionale të fituara në nivelin I, si dhe do të aftësohet të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale si më poshtë:

- Kryen punë të recepsionistit,
- Kryen punën e portierit në recepcion,
- Kryen punën e lift boy-it,
- Kryen punën e bell kapitenit,
- Kryen punën e informatorit të brendshëm në hotel,
- Pranon postën dhe ua shpërndan klientëve të hotelit,
- Kryen punën e evidentuesit në recepcion,
- Kryen punët e këmbyesit të devizave,
- Kryen punë në sektorin e marketingut,
- Ndihmon klientët rreth akomodimit,
- Përcjell klientët të cilët e lëshojnë hotelin,
- Orienton klientët në lidhje me qytetin,
- Zotëron njohuri të përgjithshme në të gjitha lëmit e jetës,
- Ruan sekretin afarist dhe atë të klientëve.

`Plani mësimor për profilin mësimor "Asistent turistik", Niveli I e II

Nr	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore dhe kreditet		
		Niveli I		Niveli II
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
A.	**Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)**	**16**	**14**	**12**
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	3 (105)	3 (105)	3 (96)
2	Gjuhë angleze	2 (70)	2 (70)	2 (64))
3	Matematikë	2 (70)	2 (70)	2 (64))
4	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	1 (35)	1 (35)	-
5	Ekonomia dhe ndërmarrësia	1 (35)	1 (35)	
6	Edukatë qytetare	1 (35)	-	-
7	Edukatë fizike	2 (70)	2 (70)	2 (64)
8	Histori	1 (350		-
9	Gjuhë gjermane	1 (35)	1 (35)	1 (32)
10	Gjuhë frënge	1(35)	1(35)	1 (32)
11	Menaxhim projekti	-	-	1 (32)
12	Kulturë arti	-	1 (32)	
13	Gjeografi	1(35)	-	-
B.	**Lëndët profesionale (Gjithsej)**	**10** (350)	**9** (315)	**8** (256)
1	Bazat e turizmit	3(105)	-	-
2	Njohje e mallit ushqimor	2(70)	-	-
3	Biologji me higjienë	2(70)	-	-
4	Bazat e shërbimit hotelier	-	3 (105)	-
5	Psikologjia e punës	-	2 (70)	-
6	Afarizmi hotelier	3 (105)	-	-
7	Organizmi i ndërmarrjes hot-turistike	-	2 (70)	2 (64)
8	Gjeografi turistike	-	2 (70)	2 (64)
9	Kontabilitet	-	-	1 (32)
10	Bazat e statistikës te klientve			1 (32)
11	Marketing turistik	-	-	2 (64)
C.	**Modulet e praktikës profesionale (Gjithsej)**	**6** (210)	**9** (315)	**12** (384)
1	Hyrje në punën praktike.	2K (20)	-	-
2	Sjellja dhe higjiena në shërbim	2K (20)	-	-
3	Punët ndihmëse në sallonet e shërbimit	2K (20)	-	-
4	Mirëmbajtja dhe përdorimi i inventarit për shërbim	2K (20)	-	-
5	Puna në depo	2K (20)		
6	Puna në banak	2K (20)	-	-
7	Njohja me repartet e kuzhinës	2K (20)		
8	Vizitë në monumentet e trashëgimisë kulturore	3K (30)		
9	Vizitë në atraksione turistike	3K (30)		

10	Vizitë në panaire të ndryshme	1K (10)		
11	Punët ndihmëse në holl të recepcionit		4K (40)	
12	Punët ndihmëse në kate të hotelit		4K (40)	
13	Punët ndihmëse në depo dhe lavatore		4K (40)	
14	Punët ndihmëse në recepcion		4K (40)	
15	Punët ndihmëse në zyre të rezervimit		5K (50)	
16	Punët ndihmëse në zyre të marketingut		5.K (50]	
17	Punët ndihmëse në sektorin e taksi shërbimit dhe kateringut		5.5K (55)	
18	Kryerja e punëve në recepsionin e hotelit			6K (60)
19	Kryerja e punëve të portierit në recepcion			6K (60)
20	Kryerja e punëve komisionarit në recepcion			6K (60)
21	Mbajtja e dokumentacionit të klientëve			6K (60)
22	Menaxhimi i informacionit të brendshëm në agjencitë turistike			6K (60)
23	Punët ndihmëse në agjencitë turistike për përgatitjen e ofertave			6K (60)
24	Mbajtja e pasqyrave dhe evidencave të rezervimeve ne agjencitë turistike			2.4K (24)
	(Gjithsej) A+B+C	**32** (1120)	**32** (1120	**32** (1050)

Modulet e praktikës profesionale Klasa 10



1.	Hyrje në punën praktike	2K (20)
2.	Sjellja dhe higjiena në shërbim	2K (20)
3.	Punët ndihmëse në sallone	2K (20)
4.	Mirëmbajtja dhe përdorimi i inventarit	2K (20)
5.	Puna në depo	2K (20)
6.	Puna në banak	2K (20)
7.	Njohja me repartet e kuzhinës	2K (20)
8.	Vizitë në monumen. e trashëgim.	3K (30)
9.	Vizitë në atraksione turistike	3K (30)
10.	Vizitë në panaire të ndryshme	1K (10)

1. "Hyrje në punën praktike"

Qëllimi modulit: Një modul teoriko-praktik që aftëson nxënësit për t'u orientuar në hotele, restorante, kafene, bare të kategorive të ndryshme, në sallat e tyre si dhe për të mirëmbajtur dhe sistemuar inventarin e shërbimit.

RM 1Nxënësi orientohet në lloje të ndryshme hotelesh, restorantesh, baresh.

RM 2 Nxënësi orientohet në sallonet ku kryhet parapërgatitja dhe shërbimi.

RM 3 Nxënësi mirëmban pajimet dhe inventarin e shërbimit.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Material të nevojshëm të artikujve ushqimorë,
- Klasa për mësim kabinetik,
- Kuzhina të restoranteve ekskluzive,
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit:

Ky modul duhet të trajtohet në punëtori, sallone për shërbim ose në hotele, motele, apo restorante reprezentative. Nxënësi duhet të jenë në kontakt me detajet dhe t'i sqarohet çdo detaj, duhet të angazhohet në vëzhgim dhe diskutime në lidhje me çështjet e ndryshme, mirësjellja, demonstrim praktik në mënyrë individuale dhe grupore. Gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të synohet sa më shumë demonstrim praktik të njohurive dhe koncepteve të fituara

2. "Sjellja dhe higjiena në shërbim"

Qëllimi modulit Një modul praktik që i aftëson nxënësit me rëndësinë e mirësjelljes si dhe me shprehitë e higjienës personale dhe higjienës në vendin e punës

RM 1 Nxënësit zbaton rregullat, kodin e mirësjelljes me udhëheqësit, kolegët dhe klientët.

RM 2 Nxënësit zbatojnë higjienën në vendin e punës.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik,
- Restorantet ekskluzive,
- Hotele të rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Ky modul duhet të trajtohet në punëtori, sallone për ofrimin e shërbimeve hoteliere ose në hotele të kategorive të larta, restorante ekskluzive. Nxënësi duhet të jetë në kontakt me detyrat e punës dhe t'i sqarohet dhe përsëritet nga disa herë. Të fitojë shprehi pune, sjellje të mirë e të kulturuar si me personelin ashtu edhe me kolegët e tij, të fitojë shprehi pune në higjienën personale dhe higjienën në vendin e punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të synohet sa më shumë demonstrim praktik të njohurive dhe kompetencave të fituara. Të mbahet ditari i punës praktike dhe të vërtetohet nga ana e mentorit.

3. "Punët ndihmëse në sallonet e shërbimit"

Qëllimi modulit: Një modul praktik që i aftëson nxënësit me funksionin e salloneve për shërbim si dhe salloneve ndihmëse shërbyese.

RM 1Nxënësi organizon tavolinat sipas skemës së shërbimit në sallë.

RM 2 Nxënësi organizon sallonet ndihmëse shërbyese sipas skemës së shërbimit.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik,
- Restorantet ekskluzive,
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Ky modul duhet të trajtohet në punëtori, sallone për ofrimin e shërbimeve hoteliere ose në hotele të kategorive të larta, restorante ekskluzive. Nxënësi duhet të jetë në kontakt me detyrat e punës dhe t'i sqarohet dhe përsëritet nga disa herë. Të fitojë shprehi pune, sjellje të mirë e të kulturuar si me personelin ashtu edhe me kolegët e tij, të fitojë shprehi pune në higjienën personale dhe higjienën në vendin e punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të synohet sa më shumë demonstrim praktik të njohurive dhe kompetencave të fituara. Të mbahet ditari i punës praktike dhe të vërtetohet nga ana e mentorit.

4. "Mirëmbajtja, përdorimi i inventarit për shërbim"

Qëllimi modulit Një modul praktik që i aftëson nxënësit për mirëmbajtjen dhe përdorimin e drejtë të inventarit për shërbim, shprehinë e punës, pastrimin, fshirjen, renditjen dhe ruajtjen e inventarit.

RM 1Nxënësi pastron dhe mirëmban porcelanet,

RM 2 Nxënësi pastron dhe mirëmban pajisjet metalike,

RM 3 Nxënësi pastron dhe mirëmban pajisjet prej qelqi.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme që të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësime kabinetike,
- Restorantet ekskluzive,
- Hotelet reprezentative.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Ky modul duhet të trajtohet në punëtori, hotele të kategorive të larta, apo restorant ekskluzive dhe atë në lokalet e përgatitjes në ofisin e restorantit. Para fillimit të shërbimit, gjatë shërbimit dhe ato të vendosen çdo inventar në vendin e vet adekuat. Duhet pasur kujdes që të ruhet inventari gjatë përdorimit, fshirja të bëhet në mënyre profesionale sipas udhëzimit të mentorit. Vlerësimi i punëve mund të bëhet në mënyrë individuale ose grupore. Të mbahet ditari i punës praktike, sa më shume demonstrim praktik dhe atë nën monitorimin nga ana e mentorit.

5. "Puna në depo"

Qëllimi modulit: Një modul praktikë që i aftëson nxënësit me rregullat e punës në depon qendrore të artikujve ushqimorë dhe pijeve si dhe materialit harxhues të domosdoshëm që deponohet si dhe me rregullat e pranimit, dhënies dhe evidentimit.

RM 1Nxënësi kryen pune ndihmëse në depon qendrore.

RM 2 Nxënësit përdor dhe mirëmban pajisjet e depos.

RM 3 Nxënësi bën pranimin e mallit në depo.

RM 4 Nxënësi bën daljet e mallit nga depoja.

Baza materiale e domosdoshme

Depoja e ndërmarrjeve të kategorive të larta të hoteleve të cilat janë të pajisura me lokalet e depos.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Ky modul duhet të trajtohet në depot e hoteleve të kategorive të larta dhe atë në depo qendrore ku depot janë të ndara e të pajisura me pajime ftohëse si dhe renditja dhe klasifikimi në mënyrë profesionale. Pranimi, kontrollimi i daljes si dhe plotësimi i dokumentacionit zyrtar; të mbahet ditari i punës praktike dhe të monitorohet nga ana e mentorit.

6. "Puna në banak"

Qëllimi modulit: Një modul praktik që i aftëson nxënësit për punë ndihmëse në banak si me pastrimin dhe sistemimin e të gjitha pajisjeve të barit dhe inventarit të barit.

RM 1Nxënësi kryen punë ndihmëse në banak.

RM 2 Nxënësi sistemon pijet në banak.

RM 3 Nxënësi kryen llogari për çmimet e pijeve.

RM 4 Nxënësi bën pranimin-dorëzimin e banakut.

RM 5 Nxënësi merr porosinë.

RM 6 Nxënësi mbikëqyr evidencimin e qarkullimit ditor.

Baza materiale e domosdoshme

Banaku i restorantit ekskluziv ose banaku në përbërje të hoteleve të kategorive të larta.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Ky modul duhet të trajtohet në banak të hoteleve reprezentative e restorante ekskluzive, që posedojnë nga të gjitha llojet e pijeve, pajime dhe inventar bashkëkohor. Të mbahet ditari i punës praktike nën monitorimin e mentorit.

7. "Njohja me repartet e kuzhinës"

Qëllimi modulit: Një modul praktik që i aftëson nxënësit me punë ndihmëse në repartet e kuzhinës, repartet ndihmëse përgatitore dhe depot e ruajtjes së artikujve ushqimor.

RM 1Nxënësi dallon përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve në repartet e kuzhinës së hotelit.

RM 2 Nxënësi dallon përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve në kuzhinën e ftohtë.

RM 3 Nxënësi dallon përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve në repartin e bukës dhe brumërave.

RM 4 Nxënësi dallon përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve në repartin e pastiçerisë.

RM 5 Nxënësi dallon përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve në repartin e përpunimit të mishit.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik,
- Kuzhina të restoranteve ekskluzive,
- Hotele të rangut të lartë

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Ky modul duhet të trajtohet në punëtori, në repartet të kuzhinës të hoteleve të kategorive të larta apo kuzhina të restoranteve ekskluzive. Nxënësit duhet të njihen në detaje me repartet e kuzhinës, ndarjen e tyre, destinimin, përgatitjet, pajimet dhe inventarin, manipulimin e drejtë me pajisje si dhe

për rëndësinë e higjienës në repartet e kuzhinës si dhe të higjienës personale. Të mbajë ditarin e punës praktike. Gjatë vlerësimit të nxënësit synohet sa më shumë demonstrim praktik të njohurive dhe kompetencave të fituara.

8. "Vizitë në monumentet e trashëgimisë kulturore"

Qëllimi modulit: Një modul praktikë që i aftëson nxënësit për organizimin e vizitave në objektet e trashëgimisë kulturore si dhe i krijon mundësi për njohjen nga afër të vlerave të objekteve të trashëgimisë.

RM 1Nxënësi organizon vizita në muze.

RM 2 Nxënësi organizon vizita në monumentet e kultit (manastire, xhami, teqe, tyrbe).

RM 3 Nxënësi organizon vizita në kulla, sahat kulla, hamame.

RM 4 Nxënësi organizon vizita në shpella, kala, ura.

Baza materiale e domosdoshme

Mësimi praktik mund të realizohet në bazë të një dite në javë ose në bllok.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Ky modul duhet të realizohet në objektet e monumenteve të trashëgimisë kulturore, të cilat i ofrojnë mundësi nxënësit për të aplikuar shkathtësitë dhe njohuritë e fituara.

Nxënësi duhet ta realizojë vizitën së bashku me mësimdhënësin dhe të informohet nga ciceroni turistik.

9. "Vizitë në atraksionet turistike"

Qëllimi modulit Një modul praktik që i aftëson nxënësit për organizimin e vizitave në objektet e atraksioneve turistike si dhe i krijon mundësi për njohjen nga afër të vlerave të tyre.

RM 1Nxënësi organizon vizita në malet e Sharrit, Grykën e Rugovës.

RM 2 Nxënësi organizon vizita në burimet natyrore (si Drini i Bardhë,
Ujëvara e Mirushes, bifurkacioni i lumit Noredime).

RM3 Nxënësi organizon vizita në liqenet artificialë dhe natyralë (si Liqeni
i Batllavës, liqeni në Bjeshkët e Namuna).

M 4 Nxënësi organizon vizita në parqet natyrore.

Baza materiale e domosdoshme

Mësimi praktik mund të realizohet në bazë të një dite në javë ose në bllok.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Ky modul duhet të realizohet në vizitat e atraksioneve turistike si Malet e Sharrit, Grykën e Rugovës, burimet natyrore, lumenjtë si Drini i Bardhë, Ujëvara e Mirushes, Bifurkacioni i lumit Nerodime, liqenet artificialë dhe natyralë, parqet si Gërmia, Blinaja, etj. Nxënësi duhet ta realizojë vizitën së bashku me mësimdhënësin dhe të informohet nga ciceroni turistik.

10. "Vizitë në panaire të ndryshme"

Qëllimi modulit:Një modul praktik që i aftëson nxënësit për organizimin e vizitave në panairet e ndryshme dhe ato turistike si dhe i krijon mundësi për njohjen nga afër të vlerave e tyre.

RM 1Nxënësi organizon vizita në panaire turistike.

RM 2 Nxënësi organizon vizita në panaire të artikujve ushqimorë.

RM 3 Nxënësi organizon vizita në panaire të pijeve freskuese, birrës dhe pijeve alkoolike.

RM 4 Nxënësi organizon vizita në panaire të librit, modës, etj.

Baza materiale e domosdoshme

Mësimi praktik mund të realizohet në bazë të një dite në javë ose në bllok.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Ky modul duhet të realizohet në vizitat e panaireve turistike, të cilët u ofrojnë mundësi nxënësve për të aplikuar shkathtësitë dhe njohuritë e fituara. Nxënësi duhet ta realizojë vizitën së bashku me mësimdhënësin dhe të informohet nga ciceroni turistik.

Modulet e praktikës profesionale
Klasa 11

Punët ndihmëse në holl të recepcionit	4K (40)
Punët ndihmëse në kate të hotelit	4K (40)
Punët ndihmëse në depo dhe lavanteri	4K (40)
Punët ndihmëse në recepcion	4K (40)
Punët ndihmëse në zyre të rezervimit	5K (50)
Punët ndihmëse në zyre të marketingut	5K (50)
Punët ndihmëse në sektorin e taksi shërbimit dhe kateringut	5.5K (55)

11. "Punët ndihmese në holl të recepsionit"

Qëllimi modulit: Një modul praktik që aftëson nxënësit për pranimin, përcjelljen e kientëve në holl të hotelit, hapjen e portës, mbartjen e bagazhit si dhe për shoqërimin deri te sallonet për shërbim.

RM 1Nxënësi ndihmon dhe shoqëron klientët në hyrje të hollit të hotelit.

RM 2 Nxënësi informon klientët për shërbimet që ofron hoteli.

RM 3 Nxënësi bën pritjen dhe përcjelljen e klientëve me bagazh prej recepcionit.

RM 4 Nxënësi kryen shërbime të thjeshta për klientin.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik,
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësuesi i praktikes duhet të përdor sa më shumë të jetë e mundur dhe demonstrim konkret të komunikimit të drejt, informimit të drejt, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejt për shërbimet të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim, shërbimin e klientëve kalimtarë, shërbimin në dreka afariste, pritjet solemne, bufe e ftoftë, koktej party si dhe shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit si dhe shërbimin e pijeve. Kryesuesi i praktikes duhet të mbikëqyr rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të synohet demonstrimi praktik i njohurive dhe koncepteve të fituara.

12. "Punët ndihmese në katet e hotelit- dhoma"

Qëllimi modulit: Një modul praktik që aftëson nxënësit për të punuar në kate, dhoma të hotelit, lavatore

RM 1Nxënesi kryen punë ndihmëse në dhoma për një person.

RM 2 Nxënësi kryen punë ndihmëse në dhomat franceze.

RM 3 Nxënësi kryen punë ndihmëse në rezidenca.

RM 4 Nxënësi kryen punë ndihmëse në apartamentet e hotelit.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik,
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajnimi i këtij moduli duhet të bëhet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësuesi i praktikes duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur dhe demonstrim konkret të komunikimit të drejt, informimit të drejt, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejtë për shërbimet të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim si dhe shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit, si dhe shërbimin e pijeve. Mësuesi i praktikes duhet të mbikëqyr rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjate vlerësimit të nxënësit duhet të synohet demonstrim praktik të njohurive dhe koncepteve të fituara.

13. "Punët ndihmese në depo dhe lavanteri të hotelit"

Qëllimi modulit:Një modul praktik që aftëson nxënësit për organizimin e punës në depo dhe lavanterinë e hotelit.

RM 1Nxënësi kryen pune ndihmese ne lavanteri të hotelit.

RM 2 Nxënësi punon në depon doracake të petkave rezervë.

RM 3 Nxënësi kryen punë ndihmese të llondinjerit.

RM 4 Nxënësi punon në depon e sendeve të harruara nga ana e klientëve.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajnimi i këtij moduli duhet të behet në hotelet e rangjeve të larta. Gjate trajnimit të modulit, mësuesi i praktikes duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur dhe demonstrim konkret të komunikimit të drejt, informimit të drejt, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejt për shërbimet të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim, shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit si dhe shërbimin e pijeve. Mësuesi i praktikes duhet te mbikëqyr rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të synohet demonstrim praktik i njohurive dhe koncepteve te fituara.

14. "Punët ndihmese në recepcion"

Qëllimi modulit Një modul praktik që i aftëson nxënësit për kryerjen e punëve ndihmese në recepsion

RM 1Nxënësi kryen punë ndihmëse në recepcion.

RM 2 Nxënësi bën pranimin dhe dorëzimin e çelësave.

RM 3 Nxënësi dorëzon postën e klientit.

RM 4 Nxënësi zgjon klientët me telefon.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik,
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajnimi i këtij moduli duhet të bëhet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësuesi i praktikes duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur dhe demonstrim konkret të komunikimit të drejt, informimit të drejt, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejt për shërbimet të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim si dhe shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit si dhe shërbimin e pijeve. Mësuesi i paktikës duhet të mbikëqyr rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të synohet demonstrim praktik i njohurive dhe koncepteve të fituara.

15. "Punët ndihmese në zyrë të rezervimit"

Qëllimi modulit: Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer veprime ndihmëse në procesin e punës në administratë, në zyrën e rezervimeve, pranimin e porosive.

RM 1Nxënësi kryen punë ndihmëse në zyrën e rezervimeve në hotel.

RM 2 Nxënësi njoftohet për çmimet e akomodimit dhe kalkulimin e tyre.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajnimi i këtij moduli duhet të bëhet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësuesi i praktikes duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur dhe demonstrim konkret të

komunikimit të drejt, informimit të drejt, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejt për shërbimet të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim si dhe shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit si dhe shërbimin e pijeve. Mësuesi i praktikës duhet të mbikëqyr rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të synohet demonstrim praktik i njohurive dhe koncepteve të fituara.

16. "Punët ndihmese në sektorin e marketingut"

Qëllimi modulit: Një modul praktik që i aftëson nxënësit për rëndesinë e sektorit të marketingut, për afarizmin e hotelit, me të gjithë sektoret për ofrim dhe shërbim, si ato të shërbimeve kryesore, gjithashtu edhe shërbimet plotësuese. Merr pjese në përpilimin e ofertave me shkrim, për institucione të ndryshme shoqërore dhe shtetërore, për kushtet që i ofron hoteli, për kapacitetet dhe bënfitin. Merr pjese në përpilimin e shkresave dhe për agjensitë turistike të vendit dhe të jashtme, merr pjesë në përpilimin e ofertave dhe shkresave për mjetet e informimit si ato elektronike si spote të ndryshme, oferta nëpër radio si dhe ofertat nëpër gazetat ditore.

RM 1Nxënësi merr pjesë në formimin e ofertës për grupe të organizuara.

RM 2 Nxënësi merr pjese në përpilimin e ofertave për agjensitë turistike vendore dhe të jashtme.

RM 3 Nxënësi merr pjesë në ofertimin e manifestimeve të ndryshme të festave shtetërore

RM 4 Nxënësi përpilon oferta për organizimin dhe manifestimin e mbrëmjeve shoqërore si mbrëmje mature, semi mature, brucoshiada, etj.

RM 5 Nxënësi merr pjesë në përpilimin e ofertave për ahengje familjare si dasma, fejesa, ditelindje.

RM 6 Nxënësi merr pjesë në përpilimin e ofertave për organizimet e drekave protokollare dhe afariste.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik,
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajnimi i këtij moduli duhet të bëhet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësuesi i praktikes duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur dhe demonstrim konkret të komunikimit të drejt, informimit të drejt, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejt për shërbimet të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim si dhe shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit si dhe shërbimin e pijeve. Mësuesi i praktikës duhet të mbikëqyr rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe

pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të synohet demonstrim praktik i njohurive dhe koncepteve të fituara.

17. "Punët ndihmese në sektorin e taksi shërbimit dhe keteringut"

Qëllimi i modulit: Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer njoftime në sektorin e taksi shërbimit dhe keteringut

RM 1Nxënësi planifikon punët ne sektorin e taksi shërbimit.

RM 2 Nxënësi organizon transportimin e grupeve te klientëve nga aeroporti deri në hotel.

RM 3 Nxënësi organizon pranimin e porosive për transportimin e klientëve deri në aeroport apo gjetiu sipas marrëveshjes.

RM 4 Nxënësi merr porosinë për ushqimin paketë/ katering.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabineti dhe - Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajnimi i këtij moduli duhet të bëhet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësuesi i praktikes duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur dhe demonstrim konkret të komunikimit të drejt, informimit të drejt, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejt për shërbimet të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim si dhe shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit si dhe shërbimin e pijeve. Mësuesi i paktikës duhet të mbikëqyr rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të synohet demonstrim praktik i njohurive dhe koncepteve të fituara.

Modulet e praktikës profesionale Klasa XII

1.	Puna në recepsionin e hotelit	6K(60)
2.	Puna e portierit në recepcion	6K(60)
3.	Puna e komisionarit në recepcion	6K(60)
4.	Bajtja e dokument. të klientëve	6K(60)
5.	Menaxhimi i informacionit të brendshëm në agjencitë turistike	6K(60)
6.	Punët ndihmëse në agjencitë turistike për përgatitjen e ofertave	6K(60)
7.	Bajtja e pasqyrave dhe evidencave të rezervimeve në agjenci turistike	2.4K(24)

18. "Kryerja e punëve në recepcionin e hotelit"

Qëllimi i modulit: Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të plotësuar dokumentacionin në recepsion, për të punuar repartin e recepsionit, në hollin dhe dhomat e hotelit, në lavatore.

RM 1 Nxënësi plotëson dokumentacionin në recepsion.

RM 2 Nxënësi punon në recepsionin e hotelit.

RM 3 Nxënësi punon në hollin e hotelit.

RM 4 Nxënësi përcjell klientin në dhomë, lavanteri, rrobaqepësi

Baza materiale e domosdoshme:

Për realizimin sa më të mirë të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjedisi, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Laboratori i recepsionit.
- Hotele të rangut të lartë ku mund të kryhen detyrat e kërkuara nga ky modul.
- Fotokopje të dokumenteve që përdoren në recepsion.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajnimi i këtij moduli duhet të realizohet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete, plotësimin e dokumentacionit në recepsion, kryerjen e punëve në recepsion, në hollin e hotelit si dhe përcjelljen e klientit në dhomë, lavanteri dhe rrobaqepësi:

Nxënësi duhet të angazhohet sa më shumë të jetë e mundur në punë konkrete për realizimin e modulit. Gjatë vlerësimit të nxënësit, duhet të synohet demonstrimi praktik i aftësive të fituara.

19. "Kryerja e punëve të portierit në recepsion"

Qëllimi i modulit: Një modul praktik që aftëson nxënësit për kryerjen e punëve dhe detyrave të portierit në hotel si gjatë ditës ashtu edhe gjatë natës.

RM 1 Nxënësi kryen punët e portierit në hotel.

RM 2 Nxënësi kryen punët e portierit të natës.

RM 3 Nxënësi kryen punët e portierit në hyrje të hotelit.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa kabineti për mësim.
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete të komunikimit të drejtë, informimit të drejtë, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për

kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejtë për të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim si dhe shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit si dhe shërbimin e pijeve.
Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit, duhet të synohet demonstrimi praktik i njohurive dhe koncepteve të fituara.

20. "Kryerja e punëve të komisionarit në recepsion"

Qëllimi i modulit Një modul praktik që aftëson nxënësit për kryerjen e punëve të lift boy-it, komisionarit, bagazhistit si dhe kryerjen e ndonjë shërbimi të imët me kërkesën e klientit dhe me urdhrin e mentorit-shefit të recepcionit.

RM 1 Nxënësi kryen punët e lift boy-it.

RM 2 Nxënësi kryen punët e komisionarit.

RM 3 Nxënësi asiston klientin gjatë akomodimit.

RM 4 Nxënësi kryen shërbime të imta për klientin me kërkesën e tij.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa kabinet për mësim,
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete të komunikimit të drejtë, informimit të drejtë, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejtë për të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim si dhe shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit si dhe shërbimin e pijeve. Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit, duhet të synohet demonstrimi praktik i njohurive dhe koncepteve të fituara.

21. "Mbajtja e dokumentacionit të klientëve"

Qëllimi i modulit Një modul praktik që aftëson nxënësit për mënyrën e evidentimit dhe regjistrimit të klientit si dhe për kryerjen e pagesave me klientët.

RM 1 Nxënësi evidenton-regjistron klientin në recepcionin e hotelit.
RM 2 Nxënësi regjistron klientin në librin e klientëve.
RM 3 Nxënësi përpilon faturën e klientit në recepsion.
RM 4 Nxënësi kryen punët përfundimtare gjatë përcjelljes së klientit.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.
- Klasa kabinet për mësim,
- Hotelet e rangut të lartë.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet në hotelet e rangjeve të larta. Gjatë trajnimit të modulit, mësimdhënësi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete të komunikimit të drejtë, informimit të drejtë, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve brenda në hotel, informimin e drejtë për të cilat ofrohen si dhe përcjelljen dhe bartjen e bagazhit deri në dhomë. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me përgatitjen dhe vlerën e inventarit dhe pajisjeve për shërbim si dhe shërbimin në dhoma dhe apartamente të hotelit si dhe shërbimin e pijeve. Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit, duhet të synohet demonstrimi praktik i njohurive dhe koncepteve të fituara.

22. "Menaxhimi i informacionit të brendshëm në agjencitë turistike"

Qëllimi i modulit Një modul praktik që aftëson nxënësit për informimin e klientëve në agjenci turistike për akomodim, ushqim dhe vendndodhje, si dhe rezervimin, informimin e klientëve për qytetin, monumentet e kultit, vendndodhjen, si dhe informimin për numrat kryesore kontaktues të institucioneve të ndryshme.

RM 1 Nxënësi informon klientët për shërbimet të cilat ofrohen në agjenci.
RM 2 Nxënësi informon klientët për vendin, qytetin apo monumentet e kultit.
RM 3 Nxënësi informon klientët për itinerarin e transportit dhe numrat e telefonave.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.
- Klasa për mësim kabinetik.
- Agjenci turistike.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet në agjencitë turistike-kompani turistike. Gjatë trajtimit të modulit, mësimdhënësi i praktikes duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete të komunikimit të drejtë, informimit të drejtë, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen

e shërbimeve. Brenda në agjenci, informimin e drejtë për shërbimet të cilat ofrohen. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me informimin e drejtë. Mësimdhënësi i praktikes duhet të mbikëqyrë rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit, duhet të synohet demonstrim praktik të njohurive dhe koncepteve.

23. "Punët ndihmëse në agjencitë turistike për përgatitjen e ofertave"

Qëllimi i modulit: Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer punë ndihmëse në agjenci turistike.

RM 1 Nxënësi merr pjesë në ofertimin për rezervimet e pushimeve verore për grupe të caktuara të organizuara për pushime në vend dhe jashtë vendit.

RM 2 Nxënësi merr pjesë në ofertimin e aranzhmaneve për pushime dimërore të organizuara në vend dhe jashtë vendit.

RM 3 Nxënësi merr pjesë në ofertimin për udhëtime të organizuara për festa të fundvitit si në vend ashtu edhe jashtë vendit.

RM 4 Nxënësi merr pjesë në ofertimin për organizimin e ekskursioneve për nxënës në vend dhe jashtë vendit.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik,
- Agjenci turistike.

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet në agjencitë turistike-kompani turistike. Gjatë trajtimit të modulit, mësimdhënësi i praktikes duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete të komunikimit të drejtë, informimit të drejtë, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve. Brenda në agjenci, informimin e drejtë për shërbimet të cilat ofrohen. Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me informimin e drejtë. Mësimdhënësi i praktikës duhet të mbikëqyrë rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës. Gjatë vlerësimit të nxënësit, duhet të synohet demonstrim praktik të njohurive dhe koncepteve.

24. "Mbajtja e pasqyrave dhe evidencat e rezervimeve në agjencitë turistike"

Qëllimi i modulit: Një modul praktik që aftëson nxënësit për të mbajtur pasqyrat dhe evidencat e rezervimeve në agjencitë turistike.

RM 1 Nxënësi regjistron klientët në librin e rezervimeve për udhëtim me aeroplan.

RM 2 Nxënësi evidencon në librin e rezervimeve për udhëtim me autobus.

RM 3 Nxënësi bën regjistrimin e rezervimit për udhëtarët me anije.

RM 4 Nxënësi merr pjesë ne ofertimin për organizimin e ekskursioneve për nxënës në vend dhe jashtë vendit.

Baza materiale e domosdoshme :

Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset e përshtatshme me pajime dhe inventar bashkëkohor.

- Klasa për mësim kabinetik.
- Agjenci turistike

Metodat e rekomanduara të të mësuarit

Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet në agjencitë turistike-kompani turistike. Gjatë trajtimit të modulit, mësimdhënësi i praktikes duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete të komunikimit të drejtë, informimit të drejtë, përcjelljen e klientit, plotësimin e kërkesave të tij për kryerjen e shërbimeve.

Brenda në agjenci, informimin e drejtë për shërbimet të cilat ofrohen.

Nxënësi duhet të angazhohet me vëzhgim dhe diskutim në lidhje me informimin e drejtë.

Mësimdhënësi i praktikes duhet të mbikëqyrë rregullat e mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës.

Gjatë vlerësimit të nxënësit, duhet të synohet demonstrim praktik të njohurive dhe koncepteve.

Ky doracak është publikuar në kuadër të programit
"Mbështetje për Zhvillimin e Arsimit dhe Punësimit – SEED faza e dytë"
i cili zbatohet nga Organizata Syri i Vizionit dhe Volkshilfe Solidarität dhe
mbështet nga Agjensioni Austriak për Zhvillim – ADA.

Kontribut në hartimin dhe përshtatjen e tij me nevojat e shkollave kanë
dhëne mësimdhënësit e drejtimit hoteleri dhe turizëm nga shkollat e
mesme profesionale ekonomike "Kadri Kusari" në Gjakovë dhe
"Ymer Prizreni" Prizren (Shqipe Mula, Ali Shehu, Arben Sufaj,
Arije Muji Sylejmani, Nuridin Halili dhe Admir Rama),

Të gjitha përmbajtjet e këtij publikimi përfaqësojnë qëndrimet e autorëve
dhe nuk reflektojnë medoemos mendimet e donatorit.

SEED Step II

DORACAK UDHËZUES

Për praktikën profesionale në shkolla të mesme profesionale
në profilet e Hotelerisë dhe Turizmit

volkshilfe. SOLIDARITÄT

Syri i Vizionit

WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN DEVELOPMENT COOPERATION